



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 20/OPK
Nr. Prot. 01-710/16
Br. Prot. 01-710/16
Nr. i faq.
Broj stranica
Data 24.02.2016
Date 24.02.2016

02

PRISTINE

DATE/A:	23/02/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03-529/16
PËR/ZA/TO:	z. Ejup KASTRATI Drejtore i Prokurimit - Komuna e Kamenicës
CC:	z. Begzad SINANI Kryetar Komune – Komuna e Kamenicës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: “Furnizim me material për zyre dhe material nga shtypi”

I nderuar z. KASTRATI

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me material për zyre dhe material nga shtypi” me numër prokurimi: 653/16/002/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull “Furnizim me material për zyre dhe material nga shtypi” me numër prokurimi: 653/16/002/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

A r s y e t i m

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna e Kamenicës keni iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: “Furnizim me material për zyre dhe material nga shtypi” me numër prokurimi: 653/16/002/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 03/02/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të hapur për furnizim.

Agjencia kundër Korrupsionit ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim të mëturjtëshëm. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në një kriter që është në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), tek Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik pika 6.4 keni kërkuar: *“Një vërtetim i nënshkruar nga administrata komunale për obligimet e kryera për gjashtëmujorin e parë 2016”* Një autoritet kontraktues mund të theksoi në dokumentacionin e kontratës organin apo organet nga të cilat një kandidat apo tenderues mund të marrë informatat e duhura për obligimet që kanë të bëjnë me tatimet, mbrojtjen e mjedisit, dispozitave të mbrojtjes së punëtorëve dhe për kushtet të cilat janë në fuqi me ligj apo rregullore në Kosovë, por në asnjë rast të kërkohej tatimi për një periudhë që ende nuk ka kaluar. Pra ende nuk është kaluar tre mujori i parë i vitit 2016, ndërsa kërkohej që tatimi të jetë paguar për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Në lidhje me tatimet mund të kërkohej një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore të vendin e themelimit të operatorit ekonomik që i njëjti nuk është me vonesë në pagesën e tatimeve, të paktën deri në çerekun e fundit të vitit.

Tutje, autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave të caktuara për prodhuesit ose operatorët ekonomik.

Veprimet e juaja si Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 23 Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, si dhe nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !